

## **Viti I Ri ne Stamboll** (29/12/2009 - 01/01/2010)

### **Dita e Parë, 29 Dhjetor 2009:**

Paraqitja në Aeroportin e Rinasit duhet të bëhet 1 orë e 30 minuta para nisjes së avionit. Fluturimi për në Stamboll. Mbërritja në Aeroport. Pritja nga përfaqësuesi ynë. Transferta nga aeroporti në hotel dhe sistemimi në hotel. Mbasdite, nën drejtimin e shoqëruesit tonë, vizitë në Qendrën Tregtare (Kapalli Çarshi).

### **Dita e Dytë, 30 Dhjetor 2009:**

Mëngjesi në Hotel. Paradite, vizitë panoramike me guidë në Monumentet Kryesore të qytetit, si: Xhamia Blu, Hipodromi, Dollmabahce, njohja me Bazilikën e famshme të Shën Sofisë, shëtitje me autobus, kalimi mbi Bririn e Artë nëpërmjet Urës së Gallatës, kalim në urat e varura të Bosforit për të kaluar në Kontinentin Aziatik, vizitë në pikën turistike të Çam Lixha (pikën më të lartë të qytetit, kodra e të dashuruarve). Darka në Hotel.

### **Dita e Tretë, 31 Dhjetor 2009:**

Udhëtim në Eminoy (stacioni i anijeve dhe jahteve për në Bosfor). Lundrim me anije për tre orë në Ngushticën e Bosforit në drejtim të Detit të Zi për të vizituar pjesën bregdetare të Stambollit, Evropën dhe Azinë, si dhe për të parë nga anija kalanë e vjetër, Rumelitisa. Mbasdite e lirë. Darka Speciale e Vitit të Ri. Muzikë, gjallëri, kostume, e fishekzjarre të ndryshme do të qëndrojnë me ju gjatë gjithë kësaj nate.

### **Dita e katërt, 1 Janar 2010:**

Mëngjesi në Hotel. Transfertë me autobus për në Aeroport. Udhëtim me avion për në Shqipëri. Mbërritja në aeroportin e Rinasit.

### **Në pagesë 420 Euro janë përfshirë:**

- Bileta e avionit vajtje – ardhje.
- Akomodimi në hotel me 3 yje superior
- Mëngjeset dhe Darkat për të gjithë ditët e qëndrimit.
- Shëtitjet në Stamboll me autobus (sipas programit)
- Shoqërues dhe guidë shqiptare, për të gjithë ditët e qëndrimit
- Transfertat Aeroport – Hotel – Aeroport
- Darka e vitit të Ri me zgjedhje opsionale ose ne Gar Muzik Holl ose (me 50 Euro shtesë) ne Hotel Eresin
- Një lundrim me anije në Bosfor 2.5 – 3 orë për të parë Europën e dhe Azinë.

### **Në pagesë nuk janë përfshirë:**

- Viza Turke 10 Euro që merret në Mbriritje në Aeroport.
- Hyrjet në Muzeume dhe Monumente.
- Gjithshka që nuk është përmendur në këtë program.

<b>Hamidiye 3*</b> Dhomë Standard (Max: 2 +1) Nata e vitit Ri e perfshire	<b>€ 420</b>
<b>Barcelo Eresin Topkapi 5*</b> Dhomë Deluxe (Max: 2 +1) Ekstra € 50	<b>€ 570</b>